



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës / Kancelarija Specialnog Tuzilastva Republike  
Kosovo / Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo

PPS nr.17/2018  
Datë: 27.11.2023  
P R I S H T I N Ë

## GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti Special -

Në bazë të nenit 234 par.2 dhe nenit 235 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), ushtroj këtë:

### A K T A K U Z Ë

për gjykim në mungesë

Kundër të pandehurit Dejan Raciq (Dejan Racić), nga i ati Janko i lindur [REDACTED], me vendbanim të panjohur, me numër të letërnjoftimit [REDACTED] lëshuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Klinë, i nacionalitetit serb, ish pjesëtarë i forcave rezervë ushtarake të Serbisë.

### S e p s e

I pandehuri Dejan Raciq, si pjesëtarë i forcave rezervë ushtarake të Serbisë, në kohën e luftës në Kosovë, në kundërshtim me rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, gjatë një sulmi të gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, kundër popullatës civile shqiptare në tërë territorin e Kosovës, duke ditur për ekzistimin e një sulmi të tillë, me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, ka kryer dhunim seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptarë.

-me çka ka kryer veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 të Kodit penal të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par.1 nën par. 1.7; të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 237, par.3, nënpar 3.1, 3.2 dhe 3.3 të KPPRK-së, janë redaktuar të dhënat për të pandehurin.

Dispozitivi dhe arsyetimi i kësaj aktakuze janë redaktuar me qëllim të mbrojtjes së identitetit të viktimës, konform nenit 237, par.3, nënpar. 3.4 , dhe par.8 të KPPRK, si dhe në përputhje me Urdhrin e gjykatës për masë mbrojtëse PPPS.nr.13/2022 të datës 07.04.2023.

Redaktimi në këtë masë është i nevojshëm për arsye se nga përshkrimi i veprës penale në dispozitivin e aktakuzës, dhe nga përmbajtja e deklaratave të viktimës dhe dëshmitarëve, si dhe të dhënave të tjera në aktakuzë, mund të zbulohet identiteti i viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, gjë që mund t'iu shkaktoj rrezik të rëndë dhe pasoja të pariparueshme.

**Drita Hajdari**  
**Prokurore e Shtetit**

